



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i KD

Prof. asoc. dr. Sabri Sadiku

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.6/2 të Statutit të Përkohshëm të Universiteti, Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 17.9.2018, mori:

Nr. Prot. 1269  
dt. 24.09.2018

**VENDIM**

**MBI KOMPENSIMIN E KOMISIONEVE DHE STAFIT TË ANGAZHUAR NË PROCESIN E PRANIMIT TË STUDENTËVE TË RINJ NË UMIB, PËR VITIN AKADEMIK 2018/2019**

- I. Në bazë të këtij vendimi do të bëhet kompensimi material për vetëm për komisionet dhe stafin e angazhuar në procesin e pranimit të studentëve për vitin akademik 2018/2019.
- II. Komisionet dhe stafin e angazhuar në kuptim të pikës I të këtij vendimi e përbëjnë:
  1. Komisioni në nivel të njësive akademike. Në rastet konkrete, në fakultete, dekanët, respektivisht u.d.dekanët kanë mundur të formojnë edhe komisionin për përpilimin e testeve me shkrim për kandidatët që i nënshtrohen provimit pranues; për vlerësimin apo kontrollimin e testeve dhe komisionin për ankesa në kuadër të njësive akademike.
  2. Pjesëmarrës të tjerë në procesin e pranimit të studentëve të rinj konsiderohen: zyrtarët për pranimin e dokumenteve në shërbimin e studentëve dhe zyrtarët e IT-së, të cilët kanë punuar jashtë orarit të rregullt të punës, si dhe gjatë ditëve të shtuna, dhe, kujdestarët e sallave ku është mbajtur testi.
- III. Pagesa për provim pranues në Fakultet do të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 17/2014, dhe varësisht prej buxhetit të krijuar nga të hyrat e provimit pranues për secilin fakultet veç e veç.
- IV. Lista e lartësisë së kompensimeve do të hartohet, në bazë të punës së secilit person të angazhuar në procesin e pranimit të studentëve të rinj në UMIB, në bazë të raportit të dekanëve të njësive akademike, por pa kaluar buxhetin nga të hyrat e provimit pranues pranë njësive akademike.
- V. Vendimit hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes, ndërsa ekzekutimi do të bëhet pas hartimit të listës së lartësisë së kompensimeve të nënshkruar nga rektori.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Menaxhmentit të UMIB-it
3. Drejtorit për buxhet dhe financiar të UMIB-it,
4. Fakulteteve

Prof. asoc. dr. Sabri Sadiku

Kryesues i KD

